




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Paper Communications SH.P.K.
NUI: 810795809

Pronari: Paper SH.P.K.

NUI: 810799942

Pronar (të Paper SH.P.K.): Ilir GRAPCI dhe
Dukagjin BEKTESHI


Emri i Biznesit: Paper Radio L.L.C.
NUI: 811487489

Pronar: Paper SH.P.K. dhe Berat MIFTARI

OSHMA: Paper Radio

OSHMA: Paper Radio

Adresa: Bulevardi Xhorxh BUSH, Aneksi i ish Radio Prishtinës, Prishtinë



VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Paper Radio, me seli në Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
1. Paper Radio është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim regional, e licencuar për transmetim të radio programeve në gjuhën shqipe me seli në Komunën e Prishtinës. Paper Radio është pajisur me licencë të KPM-së me datën 24 dhjetor 2019, me afat të licencës prej shtatë (7) vitesh.
2. Më datën 26 maj 2021, Paper Radio ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës nga biznesi Paper Communications SH.P.K. Numër Unik Identifikues 810795809 me pronar personin juridik Paper SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 810799942 dhe me person fizik si pronar z. Ilir GRAPCI dhe z. Dukagjin Bekteshi, tek biznesi Paper Radio L.L.C. me Numër Unik Identifikues (NUI) 811487489 dhe me pronarët Paper Media SH.P.K. si person juridik dhe z. Berat Miftari si person fizik.

Arsyetim


3. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
4. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
5. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
6. Me anë të kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Paper Radio, pronarët aktual kanë deklaruar se tani kanë një partneritet të ri në zhvillimin e radios.
7. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Paper Radio ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të Paper Radio, angazhimin e stafit profesional dhe ofrimin e programeve më cilësore, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare, kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare si dhe deklarata për përkrahje financiare nga disa prej bashkëpronarëve të cilët zotrojnë edhe biznesa tjera.
9. Komisioni konstaton se Paper Radio ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së.
10. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, zotimet për angazhimin e stafit profesional si dhe përvojën e në thmelimin dhe menagjimin e radios të kandidatit, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Paper Radio është në interes të publikut.
11. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

12. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datë 29 korrik 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Paper Radio nga biznesi Paper Communications SH.P.K Numër Unik Identifikues 810795809 me pronar personin juridik Paper SH.P.K me Numër Unik Identifikues 810799942 dhe me person fizik si pronar z. Ilir GRAPCI dhe z. Dukagjin Bekteshi, tek biznesi Paper Radio L.L.C. me Numër Unik Identifikues (NUI) 811487489 me pronarët Paper Media SH.P.K. si person juridik dhe z. Berat Miftari si person fizik.

13. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të Paper Radio nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



29.07.2021
datë